

VENDIM
Nr. 839, datë 28.10.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 181, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2020, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË SAMITIT DIGJITAL TË BALLKANIT PERËNDIMOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936/2016, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 181, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit, ndryshohet, dhe zëvendësohet me: “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2020, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e nevojave shtesë për subvencion, si dhe për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej 44 000 000 (dyzet e katër milionë) lekësh. Ky fond do të përdoret, si më poshtë:

a) 2 198 840 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të “Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor”, që do të organizohet në Tiranë, në datën 2 nëntor 2020.

b) 41 801 160 (dyzet e një milionë e tetëqind e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për përballimin e nevojave shtesë të vitit 2020.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe